



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1084/1 prot.

Tiranë, më 18.11.2022

NJOFTIM PËR BASHKËPUNTORË

Në kuadër të programit “Përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve nga aksesit në shërbime cilësore psiko-sociale në shkolla” të mbështetur nga UNICEF, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

1. Bashkëpunëtorët do të angazhohen për “Përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve nga aksesit në shërbime cilësore psiko-sociale në shkolla”, për aktivitetet “Aftësimi i punonjësve në ofrimin e standardeve dhe metodologjive të reja për mbështetje psikologjike” dhe “Forcimi i rrjetit të stafit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë përmes shkëmbime të rregullta” ku duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë psikologji/punonjës social/shkenca sociale/mësuesi/drejtësi.
- b) Të kenë përvojë paraprake në hartimin e dokumenteve kurrikularë, përgatitjen e materialeve mbështetëse për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë, zhvillimin e trajnimeve, monitorimin e veprimtarive në arsimin parauniversitar.
- c) Të ketë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional.
- d) Të ketë aftësi bashkëpunuese dhe të punës në grup.
- e) Preferohen përfshirje afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
- f) Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

2. Bashkëpunëtorët do të angazhohen për “Përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve nga aksesit në shërbime cilësore psiko-sociale në shkolla” për aktivitetin “Menaxhimi efektiv dhe efikas i programit” referuar kryerjes së detyrave me karakter administrativ (koordinator projekti, koordinator trajnimesh, specialist finance, jurist, specialist për marketingun dhe promovimin) duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin përkatës;
- b) Të kenë përvojë në profilin përkatës;

- c) Të ketë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional;
- d) Të ketë aftësi bashkëpunuese dhe të punës në grup;
- e) Preferohen përfshirje afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive;
- f) Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente:

- Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë,
- fotokopje e dokumentit të identitetit.
- numër llogarie bankare.

Këto dokumente do të dorëzohen pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), brenda datës 24.11.2022, ora 16.30.

Faleminderit!

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GERTI JANAQI

